

# arkadis

gemeinsam  
lebensqualität  
schaffen

Oferta jonë e pasur në lëmin e terapisë dhe këshillimit përfshin shërbimet në vijim:

- ergoterapi
- këshillim për familje
- edukim të hershëm sipas pedagogjisë speciale
- logopedi në fazën e hershme
- këshillim për nëna dhe për etër
- neonatologji
- fizioterapi
- programin “Me hapa të vegjël”
- terapi psiko-motorike

Të gjitha hollësitat – edhe ato për shërbimet tona në lëmenjtë e banimit, punës dhe kohës së lirë, – do t'i gjeni nën [www.arkadis.ch](http://www.arkadis.ch).

## **Olten**

Stiftung Arkadis  
Aarauerstrasse 10  
4600 Olten  
Nr. i tel. 062 287 00 00  
Fax 062 287 00 16  
[arkadis@arkadis.ch](mailto:arkadis@arkadis.ch)  
[www.arkadis.ch](http://www.arkadis.ch)


## **Breitenbach**

Stiftung Arkadis  
Psychomotorik-Therapie  
Bodenackerstrasse 9  
4226 Breitenbach  
Nr. i tel. 061 781 31 50  
[arkadis@arkadis.ch](mailto:arkadis@arkadis.ch)

# arkadis

gemeinsam  
lebensqualität  
schaffen

## Terapia psikomotorike



### **Terapia psiko-motorike**

Terapia psiko-motorike mbështetet në ndikimin e alternuar midis lëvizjes dhe jetës së ndjenjave të një njeriu. Lëvizja dhe loja janë metodat qendrore të terapisë psiko-motorike. Me këtë rast fëmijët përjetojnë dhe zgjerojnë aftësitë e tyre motorike, emocionale, ndijore, shpirtërore dhe sociale, si dhe përforcojnë kësisoj vetëbesimin e tyre.

Si masë plotësuese mjedisi do të sensibilizohet përmes bisedimesh dhe këshillimesh për nevojat e fëmijëve të prekur.

### **Oferta jonë**

- sqarime psiko-motorike
- terapi psiko-motorike, individualisht dhe në grupe të vogla
- këshillim për prindër dhe edukatorë

### **Për kë**

Për fëmijët e moshës së kopshtit dhe për fëmijë të moshës shkollore deri në fund të klasës së 3-të, me nevojë mbështetjeje speciale, për shkak të

- anomalive në aftësitë motorike të trasha, fine dhe shkrimore
- vështirësive perceptive;
- shqetësimeve, varfërisë lëvizore;
- problemeve në zhvillimin social dhe emocional.

### **Paraqitja nga**

- mjeket dhe mjekët
- drejtori i shkollës / mësuesi
- prindërit

### **Shpenzimet**

Oferta e terapisë psiko-motorike për prindërit është falas. Financimi realizohet prej kantonit.

